

MATEMATIKA ME TË MENDUAR NË KLASËT FILLESTARE  
SHKRIM – LEXIMI GJUHËSOR NË KLASËT FILLESTARE

# **UDHËZIME DHE KRITERE**

## **PËR CERTIFIKIMIN E MËSIMDHËNËSIT**

**SHKUP, 2012**

**Mësimdhënësit të cilët janë të trajnuar në kuadër të programit – Ndërtimi i kapaciteteve të mësimdhënësve në matematikën me të menduar dhe shkrim – leximin gjuhësor, mund të marrin certifikatë për zbatimin e njohurive të fituara në praktikën individuale.**

**Mësimdhënësi merr Certifikatë nëse;**

- e ka kaluar trajnimin për mësimdhënës;
- përpilon portfolio individual për zhvillimin profesional në të cilën ruan dëshmi për suksesin e vet;
- realizon orë të hapur i cili do të jetë i vlerësuar dhe i mbikëqyrur;
- ekipi për certifikim dhe këshilltari përgjegjës vlerësojnë se janë kritere të përmbushura për të marrë certifikatë.

## **1. KUSHTET PËR MARRJEN E CERTIFIKATËS**

### **1.1. TRAJNIM I MBARUAR**

Mësimdhënësi duhet të ketë vërtetim për pjesëmarrje në trajnim nga programi adekuat.

### **1.2. PORTFOLIO PËR PROGRAMIN**

Mësimdhënësi duhet të ketë portfolio për zhvillimin e tij profesional në kuadër të programit në të cilin është i përfshirë, në të cilin ruan dëshmi për realizimin e programit Matematika me të menduar, gjegjësisht Shkrim – leximi gjuhësor në klasat fillestare dhe atë:

1. Shënime lidhur me përvojat e realizimit të programit adekuat.
2. Materiale të ndërlidhura me realizimin e programit të cilat në mënyrë eksplicite tregojnë se programi realizohet në mënyrë adekuate në mësimin në matematikë, gjegjësisht në gjuhën amtare, siç janë:
  - Planifikimi i mësimin;
  - Materialet mësimore, fletëzat mësimore;
  - Instrumentet për vlerësim;
  - Video – incizime nga orët, fotografi;
  - Refleks për orët e realizuara;
  - Punime profesionale për të kuptuarit dhe realizimin e programit adekuat.
3. Shembuj nga orët e hapura të përcjellura me:
  - Planifikim;
  - Vetëreflektim për orën e realizuar;
4. Reflektim nga kolegët të cilët e kanë përcjell orën.
5. Shembuj nga punimet e nxënësve me komente të mësimdhënësit.

Portfolia e mësimdhënësit shërben, përveç për zhvillimin personal profesional dhe për sigurimin e dëshmive janë të nevojshme për marrjen e certifikatës për aftësim për realizimin e programit Matematika me të menduar, përkatësisht shkrim – leximi gjuhësor në klasat fillestare.

### **1.3. ORËT E REALIZUARA**

Për procesin e certifikimit mësimdhënësi duhet të ketë dëshmi më së paku dy orë të realizuara nga lënda adekuate (matematika ose/gjuhë shqipe) ose aktivitete të integruara ku në mënyrë eksplicite janë të dukshme qasjet gjatë studimit që i promovon projekti. Njëra nga ato orë duhet të jetë e mbikëqyrur nga së paku dy anëtarë të ekipit të shkollës për certifikim (një trajnues/ose një bashkëpunëtor profesional për programin).

Për të dy orët mësimdhënësit duhet në portfoliot e tyre t'i kenë këto dëshmi:

1. Përgatitjen e orës.
2. Detyrat/aktivitetet për punën e nxënësve.
3. Punimet e nxënësve që janë rezultat i aktiviteteve.
4. Refleksi i mësimdhënësit për orët e realizuar.

Për njërën nga orët, në portofoli duhet të ketë dëshmi për mbikëqyrjen e orës (kopje nga formulari i plotësuar për mbikëqyrjen e orës) nga anëtarët e ekipit për certifikim.

## 2. KRITERET PËR MARRJEN E CERTIFIKATËS

### 2.1. EVALUCIONI I PORTFOLIOS

Evaluimi i portfolios do të kryhet sipas kriterëve të dhëna më poshtë.

**Kriteret për evaluimin e dëshmimeve në portfolion:**

---

#### 1. Cilësia e planifikimit

- 1.1. Qëllimet e orës janë të definuara qartë.  
Në aktivitetet e planifikuara të mësimit dhe nxënësit ka zbatim të elementeve të programit matematika me të menduar/shkrim leximi gjuhësor
- 1.2. Janë të theksuara materiale, resurse dhe aktivitete për orën të cilat janë adekuate për mundësitë e nxënësve.
- 1.3. Struktura e orës është e ndarë në faza dhe janë të dhëna aktivitetet për secilën fazë.
- 1.4. Metodat mësimore dhe aktivitetet janë adekuate në qëllimet e parashtruara.
- 1.5. Aktivitetet e planifikuara i inkuadrojnë/angazhojnë nxënësit në procese manipuluese ose ideore.
- 1.6. Është e planifikuar qasje diferenciale e orës.
- 1.7. Është e planifikuar përcjellje dhe vlerësim i nxënësve gjatë orës.

---

#### 2. Përshtatja e detyrave/aktiviteteve për punën e nxënësve

- 2.1. Janë të dhëna detyra për punën individuale ose fleta pune për nxënësit.
- 2.2. Detyrat e dhëna për punën individuale apo në grupe janë interesante për fëmijët, të kuptimësuar mirë dhe paraqesin mënyrë adekuate për të arriturat e qëllimeve.
- 2.3. Në detyra janë theksuar udhëzime të qarta për mënyrën e punës.

---

#### 3. Cilësia e punimeve të nxënësve

- 3.1. **Janë të bashkangjitura 3 shembuj të punimeve të nxënësve nga grupe të ndryshme dhe me detyra të ndryshme.**
- 3.2. Punimet janë të përcjellura me komente adekuate të mësimit ose të bashkangjitura me instrumente të përdorura për vlerësim.

---

#### 4. Refleksi i mësimit për orën e realizuar.

- 4.1. Janë të analizuar qëllimet dhe rezultatet e pritura nga ora, si dhe arritja e saj.
- 4.2. Është e analizuar efikasiteti i orës (sa elemente të zbatuara nga programi kanë kontribuar për realizimin e qëllimeve).
- 4.3. Janë të identifikuar aspektet e procesit mësimor të cilët duhet të përmirësohen në mënyrë plotësuese ose veçanërisht janë theksuar.

Informatat reciproke për portfolion do të jepen në formularin për evaluimin e portfolios profesionale (shtojca 1)

**Portfolio konsiderohet si cilësore nëse 10 nga kërkesat e lartëpërmendura janë të përmbushura, me çka nuk guxon të ketë njësi ku as një kërkesë nuk është e përmbushur**

## **2.2. EVALUIMI I ORËS SË HAPUR**

Mbykëqyrja e orës së hapur realizohet në hapat vijues:

1. Mbledhja para mbikëqyrjes së orës ndërmjet mësimitdhënësit dhe vëzhguesit.
2. Mbikëqyrja e orës.
3. Mbledhje pas mbikëqyrjes së orës ndërmjet mësimitdhënësit dhe vëzhguesit.
4. Kompletimi dhe paraqitja e dokumenteve në portfolion nga mësimitdhënësi.

### **1. Mbledhje para vëzhgimit të orës**

Në mbledhje para mbikëqyrjes së orës bisedon me mësimitdhënësin për aspektet vijuese të orës:

- a) Qëllimet e orës.
- b) Metodrat dhe planifikimi i aktiviteteve nga programi, matematika me të menduar ose shkrim – leximi gjuhësor.
- c) Informata për aktivitetet paraprake dhe të arritura, për përbërjen e nxënësve dhe karakteristikat tjera relevante të klasës.

Mësimitdhënësi e paraqet përgatitjen e orës dhe detyrat e përgatitura punuese, gjegjësisht fletat e punës, instrumentet për vlerësim gjatë bisedës me vëzhguesin.

### **2. Mbikëqyrja e orës**

Gjatë orë vëzhguesi shfrytëzon Formular për vëzhgimin e orës me fokus të matematikës (shtojca 2) ose Formular për vëzhgimin e orës me fokus të gjuhës (shtojca 3). Cilësia e orës vlerësohet sipas këtyre kriterëve:

## **Kriteret e përgjithshme për evaluimin e orës mësimore:**

---

### **1. Përshtatja e hapësirës dhe materialet**

- 1.1. Rradhitja e karrigeve është e përshtatshme me qëllimet e mësimit.
- 1.2. Këndi i matematikës dhe i gjuhës ose qendrat janë të pajisura në mënyrë adekuate.
- 1.3. Mjetet dhe materialet për shfrytëzimin në aktivitete për nxënësit janë të kapshme lehtë.

---

### **2. Atmosfera e punës, komunikimi dhe motivimi**

- 2.1. Është prezentë atmosferë e hapur dhe pozitive dhe ka bashkëpunim në klasë.
- 2.2. Mësimdhënësi i motivon nxënësit për punë.
- 2.3. Mësimdhënësi i pranon mendimet, idetë dhe pyetjet e nxënësve.

---

### **3. Procesi mësimor dhe të mësuarit**

- 3.1 Mësimdhënësi i shfrytëzon njohuritë paraprake të nxënësve gjatë aplikimit në materialin e ri.
  - 3.2 Mësimdhënësi tregon siguri gjatë përpunimit të përmbajtjeve.
  - 3.3 Mësimdhënësi jep udhëzime të qarta për punën e detyrës së caktuar.
  - 3.4 Mësimdhënësi kontrollon/pyet se sa nxënësit e kanë kuptuar detyrën.
  - 3.5 Mësimdhënësi sipas nevojës e sqaron detyrën.
  - 3.6 Mësimdhënësi parashton pyetje që nxisin procese më të larta ideore dhe lën kohë adekuate për përgjigje.
  - 3.7 Disa nxënës marrin pjesë aktive në punën individuale dhe në grupe dhe tregojnë pavarësi në punë.
  - 3.8 Mësimdhënësi me sukses e zhvillon bisedën ndërmjet nxënësve.
  - 3.9 Nxënësit punojnë në detyrat që nxisin procese ideore dhe zgjidhje problemesh.
  - 3.10 Mësimdhënësi i inkurajon nxënësit që të parashtrojnë pyetje dhe ta shprehin mendimin e vet.
  - 3.11 Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit shembuj se si t'i zhvillojnë njohuritë e reja në situata jetësore të përditshme.
  - 3.12 Koha e aktiviteteve shfrytëzohet në mënyrë efektive.
-

---

#### **4. Vlerësimi i nxënësve**

- 4.1 Mësimdhënësi i njofton nxënësit me rezultatet e pritura të cilat duhet t'i arrijnë deri në fund të orës.
  - 4.2 Mësimdhënësi shfrytëzon veprime të ndryshme dhe instrumente për përcjelljen e punës dhe të arriturat e nxënësve.
  - 4.3 Mësimdhënësi ju jep informata reciproke nxënësve për përparimin e tyre dhe për hapat vijuese për përmirësim.
  - 4.4 Mësimdhënësi i inkudron nxënësit në vlerësim.
- 

#### **Kriteret e veçanta për evaluimin e orës mësimore**

---

##### **1. Orë me fokus në matematikë**

- 1.1 Mësimdhënësi i inkurajon nxënësit që ta shfrytëzojnë dhe ta shpërblejnë njohurinë e tyre intuitive.
- 1.2 Mësimdhënësi dhe nxënësit shfrytëzojnë vargje, modele ose tabela dri 10 ose 100.
- 1.3 Nxënësit zbulojnë rregull në varg ose format sipas rregullës së dhënë.
- 1.4 Mësimdhënësi/nxënësit shfrytëzojnë teknika të ndryshme gjatë përcaktimit të shumës, ndryshimit, prodhimit dhe herësit (numërimi, rinumërimin, mjetet manipulative, modelet, vizatimet, tabelat, diagrami,...)
- 1.5 Mësimdhënësi/nxënësit shfrytëzojnë detyra tekstuale të situatave: zgjidhje, përpilojnë ose diskutojnë detyra tekstuale.
- 1.6 Nxënësit inkurajohen që të ndajnë mënyra të ndryshme të detyrës së zgjidhur saktë.
- 1.7 Mësimdhënësi shfrytëzon detyra të hapura (me më tepër se një zgjidhje).
- 1.8 Mësimdhënësi ofron dhe pranon mënyra të ndryshme të zgjidhjes së detyrave që çojnë në zgjidhjen e saktë.
- 1.9 Mësimdhënësi/nxënësit shfrytëzojnë mjete mbikëqyrëse që të zhvillojnë koncept (nga konkretja në abstrakte), përkatësisht t'i ndërlihdin konkretën me simbolikën dhe abstrakten.
- 1.10 Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që ta sqarojnë dhe arsyetojnë mendimin matematikor nga numri më i madh i nxënësve.
- 1.11 Klasa ka pamje të këndshme dhe janë të eksponuara punimet e nxënësve nga matematika nga numri më i madh i nxënësve.

---

##### **2. Ora me fokus në gjuhën amtare**

- 2.1 Në klasë ka të ekspozuara materiale për mësimin e gjuhës (mure të fjalëve, skema alfabetike, bibliotekë klasore, materiale të shtypura nga mjedisi,).
- 2.2 Mësimdhënësi shfrytëzon tekste cilësore për lexim nga lloji i ndryshëm.
- 2.3 Puna e nxënësve është e ekspozuar (vizatime, punime të shkruara, libra individuale dhe në grupe).
- 2.4 Mësimdhënësi ju lexon me zë nxënësve.  
Nxënësit japin përgjigje të tre llojeve të pyetjeve: faktike, sfiduese dhe përmbyllëse.
- 2.5 Nxënësit parashohin se çka do të ndodhë në tregimet e jashtme.
- 2.6 Nxënësit përpilojnë tregime duke shfrytëzuar shirita me fjali, yll të tregimit, organizatorë grafik ose harta të personazheve, ngjarjeve dhe vendeve.
- 2.7 Mësimdhënësi dhe nxënësit përdorin ushtrime për lexim më të mirë dhe të kuptuarit

	e fjalëve (vokabular në katër kënde për lexim më të mirë dhe të kuptuarit e fjalëve, bingo tematik)...
2.8	Mësimdhënësi dhe nxënësit përdorin ushtrime dhe lojëra që do ta përmirësojnë shqiptimin e fjalëve (vjersha me rimë, tregime pa kuptim dhe fjalëshpejta).
2.9	Nxënësit lexojnë në vete ose lexojnë me zë për shokun tjetër ( ose lexojnë në çift me pëshpëritje).
2.10	Mësimdhënësi kërkon që nxënësit t'i sqarojnë të lexuarat/të shkruarat dhe se si e kanë bërë atë (ka lexuar, ka kuptuar, ka shkruar).
2.11	Nxënësit/mësimdhënësi përdorin ditar me shënime paralele, që të përcillet zhvillimi i mendimit.
2.12	Mësimdhënësi në mënyrë adekuate i përdor 5 hapat e parë në procesin e të shkruarit.
2.13	Mësimdhënësi përdor teknika të ndryshme në secilën hap për të shkruar, për përdorimin e gjuhës së shkruar, pjesa fillestare e përmbajtjes, pjesa përfundimtare e përmbajtjes.
2.14	Mësimdhënësi i mëson nxënësit për të shkruar (mban mini leksione).
2.15	Mësimdhënësi zbaton teknika të cilat përqendrojnë vëmendje në gramatikë, interpunksion dhe drejtshkrim.
2.16	Mësimdhënësi përdor teknika adekuate për pasurimin e fjalorit.
2.17	Nxënësit shkruajnë lloje të ndryshme të teksteve (narrative dhe informative).
2.18	Klasa ka pamje të këndshme dhe janë të ekspozuara punime të nxënësve nga gjuha nga numri i madh i nxënësve.

Një pjesë e kriterëve të posaçme mund të shihen në orën konkrete mësimore, ndërsa pjesë në planifikimin e orëve dhe materialet plotësuese në portfolion e nxënësit.

Ora e vëzhguar mendohet si e suksesshme nëse shumica e 2/3 të kriterëve të theksuara të përgjithshme plotësohen dhe 2/3 nga kriteret e theksuara të veçanta janë të përmbushura

### 3. Mbledhje pas vëzhgimit të orës

Në mbledhjen pas vëzhgimit të orës vëzhguesi/vëzhguesit bisedojnë me mësimdhënësin për pyetjet në vijim:

- a) Sa janë realizuar me sukses qëllimet e realizuara të orës?
- b) Sa ishin adekuate dhe të suksesshme metodat dhe mjetet/materialet që janë përdorur gjatë orës?
- c) Me cilat njohuri dhe shkathtësi përsoset nxënësi?
- ç) Çka do të kishte ndryshuar mësimdhënësi deri në realizim përderisa ka mundësi?



4. **Mësimdhënësi i kompletion dhe bashkangjet dokumentet në portfolio**  
Pas mbledhjes mësimdhënësi duhet të ndajë kohë dhe të bëjë reflektim individual për orët dhe më pas të kompletojë dhe bashkëngjitë në portfolio dëshmitë vijuese të orës i cili ka qenë i vëzhguar:

1. Përgatitja e orës.
2. Detyrat/aktivitetet për punën e nxënësve.
3. Punimet e nxënësve nga detyrat e dhëna në orë.
4. Reflektimi i mësimdhënësit për orën e realizuar.
5. Kopje nga Formulari për evaluimin e vëzhguesit në orë.

### **3. ORGANIZIMI I PROCESIT TË CERTIFIKIMIT**

#### **3.1 Trupat përgjegjës për certifikim**

Për zbatimin e procesit të certifikimit është përgjegjës ekipi i shkollës për certifikim, drejtori i shkollës dhe këshilltari klasor nga Byroja e zhvillimit të arsimit.

##### **3.1.2 Ekipi i shkollës për certifikim**

Ekipi i shkollës për certifikim i cili përbëhet prej 3 – 5 anëtarë e konfirmon këshilltari klasor nga Byroja e zhvillimit të arsimit:

- trajnuesit shkollor për programet adekuate (në shkollat ku nuk ka trajnues shkollor për programin adekuat – mësimdhënës të dalluar të deleguar nga aktivi i mësimi klasor);
- pedagog ose psikolog (punëtor profesional i cili ka qenë trajnues për procesin e certifikimit dhe e ka kaluar trajnimin për programet e UNICEFIT);

Ekipi shkollor për certifikim ka detyrë:

- mësimdhënësit që i kanë kaluar trajnimet t'ju sqarojnë kriteret dhe proceset e certifikimit;
- t'i planifikojë dhe zbatojë aktivitetet për certifikim;
- ta informojë këshilltarin përgjegjës klasor nga BZHA gjatë kohës së mbajtjes së orëve të hapura që do të mbykëqyren;
- të kujdeset për plotësimin e kriterëve për certifikim dhe t'i përputh me këshilltarin klasor përgjegjës nga BZHA;
- drejtorit të shkollës t'i dërgojë Vërtetime të plotësuara për certifikim.

### **3.1.2. Këshilltari përgjegjës klasor**

Këshilltarët klasor janë përgjegjës për mbajtjen e kriterëve të njëjta për certifikim në shkolla dhe për dërgimin në BZHA për vërtetim për certifikim nga shkollat në rajon. Këshilltarë klasor:

- jep udhëzime për anëtarët e ekipit të shkollës për certifikim në lidhje me procesin dhe kriteret për certifikim;
- në qershor dhe në janar shqyrton ekzemplarë të dokumentacionit për certifikimin e mësimdhënësve që e kanë kaluar procesin e certifikimit në shkolla;
- përdërisa vlerëson se janë të ruajtura kriteret për certifikim i nënshkruan vërtetimet për certifikim dhe i dërgon në BZHA që të përgatiten certifikatat;
- listën me të dhëna këshilltarët e dërgojnë te këshilltari – koordinues për programin.
- certifikatat e nënshkruara nga drejtori i BZHA i dërgon në shkollë;
- kur ka mundësi merr pjesë në disa orë të hapura për certifikim.

### **3.1.3 Drejtori i shkollës**

Drejtori i shkollës është përgjegjës për zbatimin azhurn dhe të rregullt të procesit të certifikimit. Drejtori:

- inicion formimin e ekipit për certifikim;
- ju jep përkrahje anëtarëve të ekipit për zbatimin e procesit të certifikimit;
- i nxit mësimdhënësit klasor që të marrin certifikata si pjesë e zhvillimit të tyre profesional;
- me këshilltarin përgjegjës i shikon Vërtetimet për certifikim që e ka dërguar ekipi për certifikim, ndërsa sipas nevojës edhe dokumentacionin për certifikim.
- Në mënyrë të përshtatshme i ndan certifikatat e mësimdhënësve.

## **3.2. Zbatimi i procesit të certifikimit**

Për certifikim kanë të drejtë të paraqiten të gjithë mësimdhënësit të cilët e kanë përfunduar trajnimin për programin adekuat të UNICEF – it, atëherë kur do sigurojnë dëshmi dhe vlerësojnë se i plotësojnë kushtet për certifikim. Procesi i certifikimit zhvillohet në këtë mënyrë:

1. Mësimdhënësi dërgon fletëparaqitje për certifikim në ekipin për certifikim dhe atë në mënyrë që do të jetë përgjegjës në shkollë.
2. Ekipi për certifikim bën orar për certifikim i cili përfshin rolet e anëtarëve të ekipit (cili anëtar i ekipit do të jetë përgjegjës, cilët anëtarë do të vëzhgojnë orë të hapura, si do të shqyrtohet dokumentacioni në portfolion etj).
3. Ekipi i informon këshilltarët klasor nga njëra rajonale adekuate në BZHA për orarin e orëve të hapura për certifikim (që t'i vëzhgojnë nëse kanë mundësi).
4. Pas procesit të përfunduar të certifikimit ekipi për certifikim mbledhen që të formojnë mendim të përbashkët për atë se vallë janë kriteret të përmbushura për certifikim. Anëtarët e ekipit që janë mësimdhënës klasor kanë rol kyç në vlerësimin e përputhjes së aktiviteteve të treguara mësimore me programin e UNICEFIT. Nëse këshilltari lëndor është i inkuadruar në këtë fazë mendimi i tij është vendosës.
5. Në bazë të mendimit të pajtuar, drejtorit të shkollës i dërgohet Vërtetim për certifikim që është i nënshkruar nga anëtarë i ekipit që ka qenë përgjegjës për certifikim.

6. Këshilltari përgjegjës, në qershor dhe në janar shqyrton ekzemplarë nga dokumentacioni për certifikim, bisedon me drejtorin dhe anëtarët e ekipit për procesin dhe kriteret për certifikim. Nëse konkludon se kriteret janë të mbrojtura i nënshkruan vërtetimet për certifikim dhe i dërgon në BZHA.
7. Pas nënshkrimit të certifikimit nga drejtori i BZHA, këshilltari përgjegjës certifikatat i dërgon në shkollë.

### Shtojca 1. Formular për evaluimin e portfolios profesionale

1.	Planifikimi i mësimit	Po	Jo
1.1.	Qëllimet e orës janë të definuara qartë. Në aktivitetet e planifikuara për mësimdhënësit dhe nxënësit ka realizim të programit të matematikës/shkrim – leximit gjuhësor.		
1.2.	Janë theksuar materiale dhe resurse për orët që janë adekuate për mundësitë e nxënësve.		
1.3.	Struktura e orës është e ndarë në faza dhe janë dhënë aktivitete për secilën fazë.		
1.4.	Aktivitetet e planifikuara i inkuadrojnë/ angazhojnë nxënësit në proceset manipuluese dhe ideore.		
1.5.	Është e planifikuar qasje diferencuese e orës		
1.6.	Është e planifikuar përcjellja dhe vlerësimi i nxënëve në orë.		
<b>2.</b>	<b>Përputhja e detyrave – aktiviteteve për punën e nxënësve.</b>		
2.1.	Janë të bashkangjitura detyra për punën individuale ose fleta punuese për nxënësin.		
2.2.	<i>Detyrat e dhëna për punën individuale apo në grupe janë interesante për nxënësit, të kuptimësuara mirë dhe paraqet mënyrë adekuate për të arriturat e qëllimeve.</i>		
2.3.	Në detyra janë theksuar udhëzime të qarta për mënyrën e punës.		
<b>3.</b>	<b>Cilësi për punimet e nxënësve.</b>		
3.1.	Janë të bashkangjitura së paku tre shembuj të punimeve të nxënësve nga grupe të ndryshme dhe detyra e ndryshme.		
3.2.	<i>Punimet janë të përcjellura me komente adekuate të mësimdhënësit ose të shoqëruara me përdorimin e instrumentet për vlerësim.</i>		
<b>4.</b>	<b>Refleksi i mësimdhënësit për orën e realizuar.</b>		
4.1.	Janë të analizuar qëllimet e vendosura dhe rezultatet e pritura nga ora dhe të arriturat e tyre.		
4.2.	<i>Sa elementet e zbatuara të programit kanë kontribuar për efektivitetin e orës.</i>		
4.3.	Janë të identifikuar aspektet e procesit mësimor që duhet në mënyrë plotësuse të përmirësohen ose veçanërisht të theksohen.		

Për portfolion janë të kënaqur \_\_\_\_\_ nga kërkesat e dhëna më lartë.

Portfolion e ka kontrolluar: 1. \_\_\_\_\_  
 2. \_\_\_\_\_  
 3. \_\_\_\_\_

## Shtoja 2. Formular për evaluimin e orës mësimore me fokus në matematikë

1.	Përshtatja e hapësirës dhe materialeve	Po	Jo
1.1.	Rendita e karrigeve është e përshtatshme në pajtim me qëllimet e mësimit.		
1.2.	Këndi matematikor dhe i gjuhës ose qendrat janë të pajisura në mënyrë adekuate.		
1.3.	<i>Mjetet dhe materialet për shfrytëzimin në aktivitete i kanë lehtë për qasje nxënësit.</i>		
<b>2.</b>	<b>Atmosfera e punës, komunikimi dhe motivimi.</b>		
2.1.	Është e pranishme atmosfera e hapur dhe pozitive dhe ka bashkëpunim në klasë.		
2.2.	Mësimdhënësi i motivon nxënësit për punë.		
2.3.	Mësimdhënësi i pranon mendimet, idetë dhe pyetjet e nxënësve.		
<b>3.</b>	<b>Procesi mësimor dhe mësimi</b>		
3.1	Mësimdhënësi i shfrytëzon njohuritë paraprake të nxënësve gjatë aplikimit në materialet e reja.		
3.2	Mësimdhënësi tregon siguri gjatë përpunimit të përmbajtjes.		
3.3	Mësimdhënësi jep udhëzime të qarta për punën e detyrës së caktuar.		
3.4	Mësimdhënësi kontrollon/pyet se sa nxënës e kanë kuptuar detyrën.		
3.5	Mësimdhënësi e qartëson detyrën sipas nevojës.		
3.6	Mësimdhënësi parashtron pyetje të cilat nxisin procese më të larta ideore dhe len vend adekuat për përgjigje.		
3.7	Disa nxënës marrin pjesë aktive në punën individuale dhe në grupe dhe tregojnë pavarësi në punë.		
3.8	Mësimdhënësi me sukses e zhvillon diskutimin ndërmjet nxënësve.		
3.9	Mësimdhënësi me sukses e zhvillon diskutimin ndërmjet nxënësve.		
3.10	Nxënësit punojnë në detyrat që nxisin procese ideore dhe zgjidhje të problemeve.		
3.11	Mësimdhënësi i inkurajon nxënësit të parashtrojnë pyetje dhe ta shprehin mendimin personal.		
3.12	Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit shembuj se si ta zbatojnë njohurinë e re në situata jetësor të përditshme.		
3.13	Koha e aktiviteteve shfrytëzohet me efektivitet.		
<b>4.</b>	<b>Vlerësimi i nxënësve</b>		
4.1	<i>Mësimdhënësi në mënyrë adekuate i njofton nxënësit me atë që duhet (pritet)t'i arrijnë në fund të orës.</i>		
4.2	Mësimdhënësi shfrytëzon veprime të ndryshme dhe instrumente për përcjelljen e punës dhe të arriturat e nxënësve.		
4.3	<i>Mësimdhënësi u jep informata reciproke nxënësve për përparimin e tyre dhe për hapat vijuese për përmirësim.</i>		
4.4	Mësimdhënësi i përfshin nxënësit në vlerësim		
<b>5.</b>	<b>Orë/aktivitet me fokus në matematikë</b>		
5.1	Mësimdhënësi i inkurajon nxënësit që t'i shfrytëzojnë njohuritë e veta intuitive		
5.2	Mësimdhënësi dhe nxënësit përdorin vargje, modele ose tabela deri 10 ose 100.		
5.3	Nxënësit zbulojnë rregull në varg ose formojnë varg sipas rregullës.		
5.4	Mësimdhënësi/nxënësit përdorin teknika të ndryshme gjatë përcaktimit të shumës, ndryshimit, prodhimit, herësit (numërimi, riemërimi, derinumërimi, mjetete manipuluese, modelet, vizatimet, tabelat, diagrami, ...)		
5.5	Mësimdhënësi/nxënësit përdorin detyra problematike tekstuale: zgjidhin, përpilojnë ose diskutojnë detyra tekstuale.		
5.6	Nxënësit inkurajohen të ndajnë dhe diskutojnë mënyra të ndryshme të detyrës së zgjidhur saktë.		
5.7	Mësimdhënësi përdor detyra të hapura (me më tepër se një zgjidhje e		

	saktë).		
5.8	Mësimdhënësi ofron dhe pranon mënyra të ndryshme të zgjidhjes së detyrave që çojnë në zgjidhjen e saktë.		
5.9	Mësimdhënësi/nxënësit përdorin mjete mbikëqyrëse që të zhvillojnë koncept (nga konkretja në abstrakte) gjegjësisht t'i ndërlidhin konkretën me simboliken dhe abstrakten.		
5.10	Mësimdhënësi kërkon që nxënësit ta sqarojnë dhe arsyetojnë të menduarit të tij matematikor.		
5.11	Klasa ka pamje të mirë dhe janë të ekspozuara punimet e nxënësve nga matematika nga numri i madh i nxënësve.		

**Për orën mësimore janë të përmbushura \_\_\_\_\_ nga kërkesat e njësive 1-4 dhe \_\_\_\_\_ nga kërkesat e njësive 5, të dhëna më lartë.**

**Orën e kanë vëzhguar:**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

**Mësimdhënësi:**

### Shtoja 3. Formular për evaluimin e orës mësimore me fokus në gjuhë

1.	Përshtatja e hapësirës dhe materialeve	Po	Jo
1.1.	Renditja e karrigeve është e përshtatshme në përputhje me qëllimet e mësimit.		
1.2.	Këndi i matematikës dhe i gjuhës ose qendrat janë të pajisura në mënyrë adekuate.		
1.3.	Mjetet dhe materialet për shfrytëzim në aktivitete i kanë lehtë për qasje nxënësit.		
<b>2.</b>	<b>Atmosfera e punës, komunikimi dhe motivimi.</b>		
2.1.	Është e pranishme atmosfera e hapur dhe pozitive dhe ka bashkëpunim në klasë.		
2.2.	Mësimdhënësi i motivon nxënësit për punë.		
2.3.	Mësimdhënësi i pranon mendimet, idetë dhe pyetjet e nxënësve.		
<b>3.</b>	<b>Procesi mësimor dhe mësimi</b>		
3.1	Mësimdhënësi i shfrytëzon njohuritë paraprake të nxënësve gjatë aplikimit në materialet e reja.		
3.2	Mësimdhënësi tregon siguri gjatë përpunimit të përmbajtjes.		
3.3	Mësimdhënësi jep udhëzime të qarta për punën e detyrës së caktuar.		
3.4	Mësimdhënësi kontrollon/pyet se sa nxënësit e kanë kuptuar detyrën.		
3.5	Mësimdhënësi e qartëson detyrën sipas nevojës.		
3.6	Mësimdhënësi parashtron pyetje të cilat nxisin procese më të larta ideore dhe len vend adekuat për përgjigje.		
3.7	Disa nxënës marrin pjesë aktive në punën individuale dhe në grupe dhe tregojnë pavarësi në punë.		
3.8	Mësimdhënësi me sukses e zhvillon diskutimin ndërmjet nxënësve.		
3.9	Nxënësit punojnë në detyrat që nxisin procese ideore dhe zgjidhje të problemeve.		
3.10	Mësimdhënësi i inkurajon nxënësit të parashtrojnë pyetje dhe ta shprehin mendimin personal.		
3.11	Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit shembuj se si ta zbatojnë njohurinë e re në situata jetësor të përditshme.		
3.12	Koha e aktiviteteve shfrytëzohet me efikasitet.		
3.13			
<b>4.</b>	<b>Vlerësimi i nxënësve</b>		
4.1	Mësimdhënësi në mënyrë adekuate i njofton nxënësit me atë që duhet (pritet) t'i arrijnë në fund të orës.		
4.2	Mësimdhënësi shfrytëzon veprime të ndryshme dhe instrumente për përcjelljen e punës dhe të arriturat e nxënësve.		
4.3	Mësimdhënësi u jep informata reciproke nxënësve për përparimin e tyre dhe për hapat vijuese për përmirësim.		
4.4	Mësimdhënësi i përfshin nxënësit në vlerësim		
<b>5.</b>	<b>Orë/aktivitet me fokus në gjuhën amtare.</b>		
5.1	Në klasë ka ekspozuar materiale për mësimin e gjuhës (mure të fjalëve, skema të alfabetit, biblioteka e klasës, materiale të shtypura nga mjedisi)		
5.2	Mësimdhënësi shfrytëzon tekste cilësore për lexim të llojit të ndryshëm.		
5.3	Puna e nxënësve është e ekspozuar (vizatime, punime të shkruara, libta individuale dhe në grupe).		
5.4	Mësimdhënësi ju lexon me zë nxënësve. Nxënësit japin përgjigje për të tre llojet e pyetjeve: faktik, të parashikuar dhe të përmbyllur.		
5.5	Nxënësit parashikojnë se çka do të ndodhë në tregimet e jashtme.		
5.6	Nxënësit përpilojnë tregime duke përdorur shirita me fjali, yllin e tregimit, organizuesit grafik ose harta të personazheve, ngjarje, vende.		
5.7	Mësimdhënësi përdor përdorin ushtrime për lexim më të mirë dhe të		

	kuptuarit të fjalëve (vokabular në katër kënde, bingo tematik)		
5.8	Mësimdhënësi dhe nxënësit përdorin ushtrime dhe lojëra që do ta përmirësojnë shqiptimin e fjalëve (këngë me rima, tregime pa kuptim dhe fjalëshpejta).		
5.9	Nxënësit lexojnë në vete ose lexojnë me zë për shokun (ose lexojnë në çifte me pëshpëritje).		
5.10	Mësimdhënësi kërkon që nxënësit t'i sqarojnë të shkruarat/të lexuarat dhe se si e kanë bërë atë (ka lexuar, ka kuptuar, ka shkruar). Lexo në çift dhe ndaj në grup.		
5.11	Nxënësit/mësimdhënësi përdorin ditar me shënime të dyfishta, që të përcillet zhvillimi i mendimit.		
5.12	Mësimdhënësi në mënyrë adekuate i shfrytëzon pesë hapat në procesin e të shkruarit.		
5.13	Mësimdhënësi përdor teknika të llojllojshme në secilin hap për të shkruar, për përshkrimin e gjuhës së shkruar, pjesë fillestare të përbërjes, pjesë përfundimtare e përbërjes.		
5.14	Mësimdhënësi i mëson nxënësit të shkruajnë (mban mini – lekcione)		
5.15	Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit në zbatimin e teknikave të cilat i përkushtohen gramatikës		
5.16	Mësimdhënësi përdor teknika adekuate për pasurimin e fjalorit.		
5.17	Nxënësit shkruajnë lloje të ndryshme të teksteve (narrative dhe informative).		
5.18	Klasa ka pamje të mirë dhe janë të ekspozuar punimet e nxënësve nga gjuha nga numri më i madh i nxënësve.		

**Për orën mësimore janë të përmbushura \_\_\_\_\_ nga kërkesat e njësive 1-4 dhe \_\_\_\_\_ nga kërkesat e njësive 5, të dhëna më lartë.**

**Orën e kanë vëzhguar:**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

**Mësimdhënës:**

**Shtojca 4. VËRTETIM PËR CERTIFIKIM PËR ZBATIMIN E SHKRIM –  
LEXIMIT NË KLASAT FILLESTARE**

Mësimdhënës: \_\_\_\_\_

Klasa: \_\_\_\_\_

EVALUIMI I PORTFOLIOS: DATA: \_\_\_\_\_

Shënoni me shenjë secilën nga kriteret e theksuara, nëse vlerësimi i Juaj është pozitiv.

<b>Mësimdhënësi me sukses e përpunon portfolion e vet.</b>	
<b>Në portfolion ka dëshmi nga së paku dy orë të realizuara nga gjuha amtare ose aktivitete të integruara të cilat përfshijnë gjuhën amtare ku në mënyrë eksplicite janë të dukshme qasjet në studim të cilat i promovon projekti.</b>	

EVALUIMI I ORËS SË VËZHGUAR: Data: \_\_\_\_\_

Shënoni me shenjë secilën nga kriteret, nëse vlerësimi i Juaj është pozitiv.

<b>Orë e realizuar me sukses</b>	
<b>Përgatitja e orës është dërguar.</b>	
<b>Detyrat/aktivitetet për punën e nxënësit.</b>	
<b>Përpunimet/punimet e nxënësve.</b>	
<b>Refleksi i mësimdhënësit.</b>	
<b>Disa elemente (75%) të theksuara në formular për mbykëqyrjen e ores janë të demonstruara pozitivisht.</b>	
<b>Mësimdhënësi jep analizë adekuate për suksesin e orës pas vëzhgimit</b>	

Data

Drejtor

Anëtarë e ekipit për certifikim certifikim

Këshilltarë në BZHA



**Shtojca 5. VËRTETIM PËR CERTIFIKIM PËR ZBATIMIN E MATEMATIKËS ME TË MENDUAR NË KLASAT FILLESTARE**

Mësimdhënës: \_\_\_\_\_

Klasa: \_\_\_\_\_

**EVALUIMI I PORTFOLIOS: DATA:** \_\_\_\_\_

Shënoni me shenjë secilin nga kriterët e theksuar, nëse vlerësimi i Juaj është pozitiv.

<b>Mësimdhënësi me sukses e përpunon portfolion e vet.</b>	
<b>Në portfolion ka dëshmi nga së paku dy orë të realizuara nga matematika ose aktivitete të integruara të cilat përfshijnë matematikën ku në mënyrë eksplicite janë të dukshme qasjet në studim të cilat i promovon projekti.</b>	

**EVALUIMI I ORËS SË VËZHGUAR: Data:** \_\_\_\_\_

Shënoni me shenjë secilin nga kriteret, nëse vlerësimi i Juaj është pozitiv.

<b>Orë e realizuar me sukses.</b>	
<b>Përgatitja e orës është dërguar.</b>	
<b>Detyrat/aktivitetet për punën e nxënësit.</b>	
<b>Përpunimet/punimet e nxënësve.</b>	
<b>Refleksi i mësimdhënësit.</b>	
<b>Disa elemente (75%) të theksuar në formular për mbykëqyrjen e ores janë të demonstruara pozitivisht.</b>	
<b>Mësimdhënësi jep analizë adekuate për suksesin e orës pas vëzhgimit</b>	

Data

Drejtor

Anëtarë i ekipit për certifikim

Këshilltarë në BZHA